

## **Prof. Asoc. Dr. Mirela MITI**

Propozuar nga Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës

Prof. Asoc. Dr. Miti është pjesë e personelit akademik në Departamentin e Kontabilitetit, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, prej vitit 2005 në vijim. Aktualisht, ajo është përgjegjëse e Departamentit të Kontabilitetit, F.E.U.T.

Prof. Asoc. Dr. Miti ka përfunduar studimet e larta në degën financë-kontabilitet, profili financë në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës në vitin 1999. Ka fituar gradën shkencore “Doktor” në fushën e Kontabilitetit në vitin 2013 dhe titullin akademik “Profesor i Asociuar” në vitin 2021. Ka fituar të drejtën e ushtrimit të profesioneve të lira Kontabilist i Miratuar (2003) dhe Auditues Ligjor (2008). Gjithashtu ka ndjekur kursin pasuniversitar në Universitetin e Bolonjës, Itali, i certifikuar nga Central European Initiative (2009); dhe në kuadër të projektit Erasmus+ ka zhvilluar leksione në Universitetin e Poitiers Francë.

Prof.Asoc.Dr. Miti ka një eksperiencë profesionale, e cila është e shtrirë si në sektorin publik ashtu edhe në sektorin privat, të tillë si: Inspektore finance në Prefekturën Berat (1999-2004), Anëtare e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit (2019-2022), Anëtare e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financës (2014-2015), Anëtare e Komitetit Kombëtar të Drejtimit i ngritur në Ministrinë e Financës, për projektin “Zhvillimi i Kontabilitetit në sektorin Publik” (2018 dhe në vijim), eksperte lokale e projektit në nivel kombëtar “Zhvillimi i qëndrueshëm i kapaciteteve të sektorit të ujit në Shqipëri”, etj.

Ajo është bashkëautore e Librit “Kontabiliteti i Kostos” botim ndërkombëtar i parë në gjuhë shqipe (2015); është autore dhe bashkëautore e mjaft punimeve shkencorë të botuar në revista ndërkombëtare apo të referuara në konferenca ndërkombëtare të mbajtura në Gjermani, Francë, Luksemburg, Austri, Turqi, Shqipëri, etj. Aktualisht është pjesë e bordit editorial të disa revistave shkencore ndërkombëtare, trajnere në fushën e standardeve të kontabilitetit, anëtare e organizatave profesionale IKM dhe IEKA, si dhe në mënyrë të vazhdueshme zhvillon konsulencë në fushën e kontabilitetit, auditimit dhe analizës së pasqyrave financiare për njësitë ekonomike që ushtrojnë aktivitete në sektorë të ndryshëm.

**Prof. Asoc. Dr. Mirela MITI**

Proposed by the Faculty of Economy, University of Tirana

Prof. Asoc. Dr. Miti is a member of the academic staff at the Department of Accounting, Faculty of Economics, University of Tirana since 2005. Currently, she holds the position of the Head of Accounting Department, F.E.U.T.

Prof. Asoc. Dr. Miti completed her studies in finance-accounting, specializing in finance, at the Faculty of Economics, University of Tirana, in 1999. She earned the academic degree of "Doctor" in the field of Accounting in 2013 and the academic title of "Associate Professor" in 2021. She obtained the right to practice liberal professions as Certified Accountant (2003) and Legal Auditor (2008). Additionally, she attended a postgraduate course at the University of Bologna, Italy, certified by the Central European Initiative (2009), and, as part of the Erasmus+ project, she conducted lectures at the University of Poitiers in France.

Prof. Assoc. Dr. Miti has professional experience spanning both the public and private sectors, including: Finance Inspector at the Prefecture of Berat (1999-2004), Member of the External Evaluation Commission (2019-2022), Member of the Internal Audit Committee at the Ministry of Finance (2014-2015), Member of the National Steering Committee established at the Ministry of Finance for the project "Development of Accounting in the Public Sector" (2018 and ongoing), and local expert for the national project "Sustainable Development of Water Sector Capacities in Albania," among others.

She is a co-author of the book "Accounting of Costs" the first international publication in Albanian language (2015). She is also the author and co-author of numerous scientific papers published in international journals or presented at international conferences held in Germany, France, Luxembourg, Austria, Turkey, Albania, etc. Currently, she is part of the editorial board of several international scientific journals, a trainer in the field of accounting standards, a member of professional organizations such as IKM and IEKA, and continuously provides consulting in the areas of accounting, auditing, and financial statement analysis for economic entities operating in various sectors.